



Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung  
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare



# Newsletter

## June 14th

Icon Tower (Kati 9)  
Rr. Bekim Fehmiu 110,  
10000 Prishtinë, Kosovë

[www.oegjk.org](http://www.oegjk.org)

# UPCOMING EVENTS IMPORTANT DATES



**June 19 – 20**

**Unchain Festival,  
Oradea (Romania)**

**July 1**

**“Women Going Digital”**

**September 24**


**“10 Years of the Berlin Process –  
The Western Balkans as an Economic  
Area on the Path to the EU”, BMWK  
Conference Center in Berlin**

**October 1**

**SUBEX, Pristina**

**October 2-3**

**2nd German-Kosovar Economic Forum,  
Pristina**



Newsletter  
June 7th

# Director's Note

## **Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare**

Në këtë edicion të Newsletter, ju sjellim përmbledhjen më të fundit të lajmeve të aktiviteteve tona si dhe partnerëve. Këto përfshijnë pjesëmarrjen e kompanive kosovare në takimet B2B në kuadër të BME-Iniciativës për Blerje në Ballkanin Perëndimor në Gjermani, lansimin e programit “Women Going Digital”, Përkujtimi i 25 Viteve të paqes dhe lirisë në Kosovë, takimi me Presidentin e IHK Lübeck, Hagen Goldbeck, takimi në kuadër të forumeve sektoriale, ngjarja “Demo Day”, pjesëmarrja e Numarics në garën për çmimin TOP 100 Swiss Startup, Konferenca për Ditën Botërore të Konsulentit, dëgjimi publik për Projektligjin për krypto-asete, anketa për pjesëmarrjen e shkollave të mesme profesionale në mësimin në vendin e punës dhe Buletini javor i Green Digest.

Ju falenderojmë që jeni pjesë e komunitetit tonë!

## **Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

In this edition of our newsletter, we bring you a summary of our latest news and activities, as well as updates from our partners. These include the participation of Kosovar companies in in B2B Meetings within the BME-Western Balkans Purchasing Initiative in Germany, the launch of the “Women Going Digital” Program, meeting with IHK Lübeck President, Hagen Goldbeck, commemoration 25 Years of peace and freedom in Kosovo, the meeting within the framework of the sectoral forums, the “Demo Day” event, Numarics participating in the TOP 100 Swiss Startup competition, the Conference for World Consultant Day, the public hearing for the Draft Law on Crypto-Assets, Survey on vocational school engagement in workplace learning, the weekly newsletter by Green Digest.

We thank you for being part of our community!

## Kompanitë kosovare, pjesëmarrëse në takimet B2B në kuadër të BME-Iniciativës për Blerje në Ballkanin Perëndimor në Gjermani

Me datë 11 dhe 12 Qershor janë realizuar mbi 250 takime B2B në kuadër të edicionit të 10-të të Iniciativës për Blerje në Ballkanin Perëndimor, në München të Gjermanisë.

Kjo ngjarje u organizua nga Asociacioni Federal për Menaxhimin e Zingjirit të furnizimit, Blerje dhe Logjistikë (BME) në bashkëpunim me Ministrinë Federale për Ekonomi dhe Mbrojtje Klimatike (BMWK) dhe Rrjetin e Odave Ekonomike Gjermane të Jashtme (AHK).

Mbi 120 furnizues nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë kompanitë Automatics-KS, Hymeri Metals, Rronifer dhe K-AKS nga Kosova, janë kualifikuar dhe ishin pjesë e takimeve B2B me 20 kompanitë blerëse gjermane, të cilat janë në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të zingjirit të furnizimit për kompanitë e tyre.

Që nga viti 2014, në kuadër të kësaj iniciative janë realizuar mbi 4000 takime B2B ndërmjet kompanive gjermane dhe kompanive të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për të mbështetur kompanitë nga Kosova në takimet B2B si dhe si partner organizativ i kësaj iniciative, OEGJK u përfaqësua nga Besarta Hyseni, Udhëheqëse e Departamentit për Hyrje në Treg dhe Jeta Sylja, Asistente e Projektit.

Përveç pjesëmarrjes në takimet B2B, delegacioni kosovar me ftesë të veçantë nga Konsulli Gjeneral i Ambasadës së Republikës së Kosovës në München, z. Afrim Nura, kishte nderin të marr pjesë në pritjen shtetërore me rastin e 25. Vjetorit të Çlirimit të Kosovës.

## Kosovar Companies Participating in B2B Meetings within the BME-Western Balkans Purchasing Initiative in Germany

On June 11th and 12th, over 250 B2B meetings were held as part of the 10th edition of the Western Balkans Procurement Initiative in Munich, Germany.

This event was organized by the German Association of Materials Management, Purchasing and Logistics (BME) in cooperation with the Federal Ministry for Economic Affairs and Climate Action (BMWK) and the Network of German Chambers of Commerce Abroad (AHK).

More than 120 suppliers from Western Balkan countries, including companies like Automatics-KS, Hymeri Metals, Rronifer, and K-AKS from Kosovo, qualified and participated in B2B meetings with 20 German buying companies, who are continuously seeking supply chain solutions for their companies.

Since 2014, this initiative has facilitated over 4,000 B2B meetings between German companies and companies from Western Balkan countries.

To support companies from Kosovo in the B2B meetings and as a partner organization of this initiative, the German-Kosovar Business Association was represented by Besarta Hyseni, Head of the Market Entry Department, and Jeta Sylja, Project Assistant.

In addition to participating in the B2B meetings, the Kosovar delegation, upon special invitation from the Consul General of the Embassy of the Republic of Kosovo in Munich, Mr. Afrim Nura, had the honor of attending the state reception commemorating the 25th anniversary of Kosovo's Liberation.



## U lansua Programi “Women Going Digital”

Me datë 13 Qershor, u mbajt event i informues për programin Women Going Digital.

Programi i certifikuar i trajnimit online fillon në korrik dhe mundësia për të regjistruar është e hapur deri në mes të shtatorit. Programi ka për qëllim fuqizimin e grave nga Maqedonia Veriore, Kosova dhe Shqipëria duke i pajisur ato me aftësi të nevojshme në transformimin digjital.

Women Going Digital implementohet nga AHK Nordmazedonien në bashkëpunim me KDWW dhe DIHA si partnerët rajonalë dhe është dëshmi e një përpjekjeje të përbashkët për të nxitur progress në rajon.

Programi përfshin 16 module të dinamikës që përmbajnë video, podcast-e dhe revista digjitale në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Ai zgjat 20 orë dhe pjesëmarrësit mund të qasen në kohën e tyre të lirë.

Me një çmim prej vetëm 25 EUR për person, trajnimi synon të fuqizojë aftësitë e inovacionit digjital, veçanërisht në sektorët e administratës, prodhimit dhe bujqësisë. Edhe pse programi është i përshtatur për gratë në këto industri, programi mirëpret të gjithë ata që janë të interesuar të suksesojnë në erën digjitale.

## The “Women Going Digital” Program was launched

On June 13, the kickoff event for the “Women Going Digital” Program was held.

The certified online training program starts this July and the opportunity to enroll will be open until Mid-September. The program aims to empower women from North Macedonia, Kosovo, and Albania by equipping them with essential skills in digital transformation.

Implemented by AHK Nordmazedonien in collaboration with KDWW and DIHA as regional partners, this initiative signifies a collaborative effort to drive progress in our region.

The program consists of 16 dynamic modules featuring videos, podcasts, and digital magazines in Macedonian and Albanian. It spans 20 hours and is flexible for participants to access at their convenience.

Priced at just 25 EUR per person, the training aims to enhance digital innovation capabilities, particularly in the administration, production, and agriculture sectors. While tailored for women in these industries, the program welcomes anyone eager to thrive in the digital era.

---

## Përkujtimi i 25 viteve të paqes dhe lirisë në Kosovë

Më 12 qershor, Kosova festoi 25-vjetorin e ndërhyrjes së udhëhequr nga NATO që solli paqe dhe liri në rajon. Pritja Shtetërore e organizuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Dr. Vjosa Osmani-Sadriu, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ishte një rikujtim i zhvillimit si dhe qëndrueshmërisë së popullit kosovar.

Drejtoresha Ekzekutive, Nora Hasani mori pjesë në Pritjen Shtetërore, në një ditë të mbushur me tregime emocionale dhe reflektime mbi 25 vitet e fundit. Ky rast theksoi forcën dhe vendosmërinë që kanë drejtuar udhëtimin e Kosovës drejt paqes dhe prosperitetit.

## Commemoration of 25 years of peace and freedom in Kosovo

On June 12th, Kosovo celebrated the 25th anniversary of the NATO-led intervention that brought peace and freedom to the region. The State Reception, organized by the President of the Republic of Kosovo, Dr. Vjosa Osmani-Sadriu, the Speaker of the Assembly of the Republic of Kosovo, Glauk Konjufca, and the Prime Minister of the Republic of Kosovo, Albin Kurti, was a reminder of the development and resilience of the Kosovar people.

Our Executive Director, Nora Hasani, participated in the State Reception, a day filled with emotional stories and reflections on the past 25 years. This occasion highlighted the strength and determination that have guided Kosovo's journey towards peace and prosperity.

## Takimi në Prishtinë: Diskutime për bashkëpunimin biznesor Gjermano-Kosovar

Drejtoresha Ekzekutive e OEGJK, Nora Hasani, ka pritur në takim Hagen Goldbeck, President i Dhomës së Industrisë dhe Tregtisë në Lübeck, dhe Antje Wandelt, e deleguara nga Ekonomia Gjermane në Odën e Jashtme Gjermane të Maqedonisë Veriore.

Ky takim shërbeu si një mundësi e vlefshme për të diskutuar tema që kanë lidhje me marrëdhëniet bilaterale të biznesit, përfshirë iniciativat për sistemin e arsimit dual, strukturat ligjore dhe dinamikat aktuale të tregut të punës lokale.

Këto janë takime të rëndësishme në përpjekjet tona për të avancuar bashkëpunimin ekonomik dhe për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për lidhjet biznesore mes Kosovës dhe Gjermanisë.

Angazhimet e tilla nënvizojnë përkushtimin tonë për të lehtësuar dialogun e rëndësishëm dhe për të adresuar sfidat e rëndësishme me të cilat përballen bizneset në Kosovë.

## Meeting in Pristina: Discussions on German-Kosovar business cooperation

The Executive Director of KDWW, Nora Hasani, met with Hagen Goldbeck, President of the Chamber of Industry and Commerce in Lübeck, and Antje Wandelt, Delegate of the German Economy from the German Chamber of Commerce in North Macedonia.

Ms. Hasani briefed Mr. Goldbeck on economic developments in the country, access to the Kosovo market for investors, especially German ones, and the role of OEGJK in strengthening economic relations between Kosovo and Germany. In addition, discussions focused on current legal infrastructure and initiatives for the dual education system.

These meetings are crucial in our efforts to advance economic cooperation and create a conducive environment for business between Kosovo and Germany.



## OEGJK merr pjesë në takimin e Forumeve Sektoriale

Gjatë kësaj jave u mbajtën takimet e forumeve sektoriale, të organizuara nga Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI).

Në përputhje me misionin për përkrahjen e dialogut publiko-privat, OEGJK mori pjesë në takimin sektorial ku u diskutuan qasjet për themelimin, financimin, shfrytëzimin dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të parqeve industriale në Kosovë, me fokus në zhvillimet nga Ligji Nr. 08/L-208 për Parket Industriale dhe Teknologjike.

OEGJK mbetet e përkushtuar në mbrojtjen e interesave dhe shqetësimeve të anëtarëve të saj përmes angazhimit të vazhdueshëm dhe përkushtimit në dialogun publiko-privat.

## KDWV part of the meeting of the Sectoral Forums

During this week, the meetings of the sectoral forums, organized by the National Council for Economy and Investments (KKEI), were held.

In accordance with the mission to support the public-private dialogue, KDWV participated in the sectoral meeting where approaches were discussed for the establishment, financing, use and improvement of the management efficiency of industrial parks in Kosovo, with a focus on the developments from Law No. 08/L-208 for Industrial and Technological Parks.

KDWV remains committed to protecting the interests and concerns of its members through continuous engagement and dedication in the public-private dialogue.



## Makerspace prezanton startup-et innovative përmes “Demo Day”

Qendra e Inovacionit Makerspace në Prizren po organizon "Demo Day" më 20 Qershor 2024 nga ora 14:00, në Sallën e Konferencave të ITP Prizren.

Ngjarja synon të theksojë idetë biznesore transformative që dalin nga programi i tyre i inkubimit "Idea-to-Scale."

Njëmbëdhjetë startup-e nga kohorta e dytë e programit "Idea-to-Scale" do të prezantojnë zgjidhjet e tyre biznesore, duke shfaqur strategjitë dhe potencialin e tyre ndërsa angazhohen me investitorët potencialë që marrin pjesë në ngjarje. Demo Day shërben si një platformë për të lehtësuar lidhjet midis startup-eve që kërkojnë investime, partneritete dhe mundësi rrjetëzimi me profesionistë në fusha të ngjashme.

Programi Idea-to-Scale zbatohet nga Makerspace Innovation Center në ITP Prizren, në kuadër të Digital Transformation Center, dhe përkrahët nga GIZ Kosovo dhe Komuna e Prizrenit.

Për më shumë informacione rreth programit "Idea-to-Scale" dhe detajet e pjesëmarrjes në Demo Day: [Makerspace Innovation Center Prizren \(makerspaceprizren.com\)](https://makerspaceprizren.com)

## Makerspace Innovation Center showcases innovative startups through “Demo Day”

Makerspace Innovation Center in Prizren is hosting "Demo Day" on June 20, 2024, starting at 14:00, at the Conference Hall of ITP Prizren. The event aims to highlight transformative business ideas emerging from their "Idea-to-Scale" incubation program.

Eleven startups from the second cohort of the "Idea-to-Scale" program will present their business solutions, showcasing their strategies and potential while engaging with potential investors attending the event. Demo Day serves as a platform to facilitate connections among startups seeking investments, partnerships, and networking opportunities with professionals in related fields.

The Idea-to-Scale program is implemented by Makerspace Innovation Center at ITP Prizren, under the Digital Transformation Center, and is supported by GIZ Kosovo and the Municipality of Prizren.

For more information about the "Idea-to-Scale" program and details on participating in Demo Day, visit: [Makerspace Innovation Center Prizren \(makerspaceprizren.com\)](https://makerspaceprizren.com).



## Konferenca për Ditën Botërore të Konsulentit: Roli i ESG-së në Zhvillimin e Sektorit Privat

Më 12 Qershor u mbajt Konferenca për Ditën Botërore të Konsulentit, e organizuar nga Business Consultants Council me mbështetjen e USAID Compete Activity.

Fokusi i Konferencës ishte roli i ESG-së (komponenta mjedisore, sociale dhe të qeverisjes) si një kornizë udhëzuese për sektorin privat.

Nora Hasani, Drejtoreshë Ekzekutive e OEGJK, prezantoi dhe theksoi rëndësinë e ESG-së për bizneset, duke përfshirë aspektet e tregjeve të jashtme, eksportit, menaxhimit të ndryshimit, dhe rolin e parimeve të ESG në rritjen e biznesit, si në nivele lokale ashtu edhe ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit poashtu patën mundësinë të ndajnë idetë e tyre me donatorë, konsulentë, përfaqësues biznesi dhe partnerë.

Për informim dhe këshillim rreth ESG dhe Ligjit për zinxhir të furnizimit, na kontaktoni në [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org).

## Conference for World Consultant Day: The Role of ESG in the Development of the Private Sector

On June 12, the Conference for World Consultant Day was held, organized by the Business Consultants Council with the support of the USAID Compete Activity.

The focus of the conference was the role of ESG (environmental, social, and governance components) as a guiding framework for the private sector.

Nora Hasani, Executive Director of the German-Kosovar Business Association (KDWM), presented and emphasized the importance of ESG for businesses, including aspects of foreign markets, export, change management, and the role of ESG principles in business growth, both locally and internationally.

Participants also had the opportunity to share their ideas with donors, consultants, business representatives, and partners.

For information and advice on ESG and the Supply Chain Law, contact us at [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org).



## Kuvendi i Kosovës mban dëgjim publik për Projektligjin për kripto-asete

Më 20 Qershor 2024, do të mbahet një dëgjim publik për Projektligjin për Kripto-Asetet. Kuvendi i Kosovës ka ftuar Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) të marrë pjesë në këtë takim.

Projektligjin, që synon të rregullojë fushën në zhvillim të kripto-aseteve, mund ta gjeni [këtu](#).

Anëtarët që dëshirojnë të kontribuojnë me sugjerimet dhe idetë e tyre, mund të dërgojnë komentet e tyre në [reze.gashi@oegjk.org](mailto:reze.gashi@oegjk.org) deri më 19 Qershor 2024. Këto komente do të përpilohen dhe do të prezantohen në dëgjim në emër të anëtarësisë së OEGJK-së.

## Anketa për pjesëmarrjen e shkollave të mesme profesionale në mësimin në vendin e punës

Aktiviteti i USAID-it për zhvillimin e fuqisë punëtore përmes sektorit privat është duke realizuar një anketë me biznese në lidhje me angazhimin e nxënësve të shkollave të mesme profesionale në mësimin në vendin e punës.

Qëllimi i këtij anketimi është të kuptohen aspekte të ndryshme të angazhimit të bizneseve në implementimin e të mësuarit në vendin e punës përmes angazhimit të nxënësve të shkollave të mesme profesionale. Këto përgjigje do të ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit të mësimin në vendin e punës dhe identifikimin e fushave potenciale për përmirësim. Të dhëna do t'i ndihmojnë grupeve punuese të politikave të themeluara nga Aktiviteti, për të propozuar tek Qeveria intervenime konkrete në politika publike që lidhen me edukimin profesional.

Pyetësin mund t'a gjeni në këtë link:  
[https://docs.google.com/forms/d/1sji0Jqm43rXjGs45zaCp30Ab-8P1UopT4ux1wt\\_bNg/edit](https://docs.google.com/forms/d/1sji0Jqm43rXjGs45zaCp30Ab-8P1UopT4ux1wt_bNg/edit)

Data e fundit për plotësimin e pyetësit është 21 Qershor.

## The Assembly of Kosovo organizes a public hearing for the Draft Law on Crypto-Assets

On June 20, 2024, a public hearing will be held for the Draft Law on Crypto-Assets. The Assembly of Kosovo has invited the German-Kosovar Business Association (KDWW) to participate in this meeting.

The draft law, which aims to regulate the emerging field of crypto-assets, can be found [here](#).

Members who wish to contribute with their suggestions and ideas can send their comments to [reze.gashi@oegjk.org](mailto:reze.gashi@oegjk.org) by June 19, 2024. These comments will be compiled and presented at the hearing on behalf of KDWW's membership.

## Survey on vocational school engagement in workplace learning

USAID's Workforce Development Activity through the private sector is conducting a survey with businesses regarding the engagement of vocational high school students in workplace learning.

The purpose of this survey is to understand various aspects of business engagement in the implementation of workplace learning through the involvement of vocational high school students. These responses will help in assessing the effectiveness of workplace learning and identifying potential areas for improvement. The data will assist the Policy Working Groups established by the Activity in proposing specific public policy interventions related to vocational education to the Government.

The questionnaire can be found in the following link:  
[https://docs.google.com/forms/d/1sji0Jqm43rXjGs45zaCp30Ab-8P1UopT4ux1wt\\_bNg/edit](https://docs.google.com/forms/d/1sji0Jqm43rXjGs45zaCp30Ab-8P1UopT4ux1wt_bNg/edit)

The last date for completing the questionnaire is June 21.

## Green Digest: Informohuni për ESG dhe Qëndrueshmëri

Green Digest është një buletin javor i krijuar për të ndihmuar profesionistët e Sustainability & ESG të qëndrojnë të informuar dhe të përditësuar. Ekipi i Green Digest shqyrton me kujdes dhjetëra artikuj dhe të dhëna çdo ditë nga burimet më të besueshme për të sjellë lajmet dhe analizat më të rëndësishme në një format lehtë të lexueshëm.

Green Digest lexohet nga profesionistë nga Deloitte, EY, BNP Paribas, BlackRock, Morgan Stanley, Goldman Sachs, Moody's, Accenture dhe shumë të tjerë nga kompanitë prej S&P500, organizatat jofitimprurëse, akademia dhe organizatat qeveritare.

Green Digest dërgon 2 buletine javore:

- E martë - Një përmbledhje më pak se 10 minuta mbi lajmet më të fundit javore nga sektori i ESG dhe Qëndrueshmërisë, përfshirë politikën, ligjet dhe direktivat e reja, 'sustainable finance', qëndrueshmëria e korporatave dhe gjithçka tjetër në mes.
- E enjte - një analizë të ndikimit mjedisor dhe social të një kompanie, e llogaritur duke përdorur një sistem unik vlerësimi.

Për t'u abonuar falas, klikoni këtu:  
<https://www.greendigest.co/>

## Green Digest: Stay informed on ESG & Sustainability

Green Digest is a weekly newsletter designed to help Sustainability & ESG professionals stay informed and updated. The Green Digest team carefully goes through tons of articles and data every day and scours the most credible sources to bring the most important news and insights in a digestible format.

The newsletter is read by professionals from Deloitte, EY, BNP Paribas, BlackRock, Morgan Stanley, Goldman Sachs, Moody's, Accenture, and many others from S&P500 companies, nonprofits, academia, and government organizations.

Here's what to expect:

- Tuesday - A less than 10-minute brief to catch up on the latest news, insights, and more from the past week in the ESG, Climate, and Sustainability sector. You'll learn about new regulations, policies, sustainable finance, corporate sustainability, and everything in between.
- Thursday - an in-depth analysis of a company's environmental and social impact, quantified using a unique scoring system.

To subscribe for free, you can do so here:  
<https://www.greendigest.co/>



ESG & Sustainability news and insights  
in a summarized and easy-to-read format

Trusted by professionals from:

S&P Global Deloitte. Google MOODY'S EY

## Numarics merr pjesë në garën për çmimin TOP 100 Swiss Startup!

Me kënaqësi ju njoftojmë se kompania jonë anëtare, Numarics, është pjesë e garës prestigjioze TOP 100 Swiss Startup, e cila do të përzgjedh 100 startup-et më inovative dhe premtuese në Zvicër.

Çmimi TOP 100 Swiss Startup përfshin vlerësime nga ekspertët dhe votimin publik. Këtë vit, ju keni mundësinë të ofroni mbështetjen tuaj për Numarics gjatë fazës së votimit publik TOP 100. Vota juaj do të luajë një rol vendimtar në theksimin e Numarics si një startup i dalluar zviceran.

Si të votoni: Vizitoni profilin e Numarics AG në [Numarics AG - startup.ch](https://www.numarics.ch/startup) për të mësuar më shumë rreth çmimit Swiss Startup dhe për të dhënë votën tuaj për Numarics.

Pjesëmarrja juaj do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme për të treguar arritjet dhe potencialin e tyre.

## Numarics is participating in the TOP 100 Swiss Startup competition!

We are pleased to inform you that our member company, Numarics, is participating in the prestigious TOP 100 Swiss Startup competition, which selects the 100 most innovative and promising startups in Switzerland.

The TOP 100 Swiss Startup award includes evaluations from experts and public voting. This year, you have the opportunity to show your support for Numarics during the public voting phase of TOP 100.

Your vote will play a crucial role in highlighting Numarics as a distinguished Swiss startup. How to vote: Visit Numarics AG's profile on [Numarics AG - startup.ch](https://www.numarics.ch/startup) to learn more about the Swiss Startup award and to cast your vote for Numarics.

Your participation will significantly contribute to showcasing their achievements and potential.

YOUR  
CONTACT PERSON  
AT KDWW

---

Monday / Friday  
08:30 – 16:30

---

BOOK  
YOUR APPOINTMENT  
AT KDWW-OEGJK

---

Icon Tower (Kati 9)  
Rr. Bekim Fehmiu 110,  
10000 Prishtinë, Kosovë

---




**Koordinatorë**

**Coordinator**

**Department  
for Advocacy and  
Government Relations**

**Rreze Gashi**

[rreze.gashi@oegjk.org](mailto:rreze.gashi@oegjk.org)



Icon Tower (Kati 9)  
Rr. Bekim Fehmiu 110,  
10000 Prishtinë, Kosovë

[www.oegjk.org](http://www.oegjk.org)